

6.03.2022

Ora 00:42

RENDI I DITËS

Hedhja e shortit “Për caktimin e relatorit të Kërkesës Ankimore nr. 7,
dt.5.03.2022, subjekti ankues Partia Demokratike”.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Y. Merkaj, E. Mema.
- **Parti Politike:** PD (M. Logu)

Z. Y. Merkaj: Përshëndetje të gjithëve, fillojmë me procedurën e shortit. Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur Kërkesa Ankimore nr. 7, me ankues Partia Demokratike. Objekt i ankimit është “Kundërshtimi i vendimit të KZAZ-së nr. 26, Vorë, nr. 171, dt.5.03.2022 “Për mosmiratimin e listës shumemërore të paraqitur nga personat kryesisht që kanë aplikuar për anëtarë të KQV-së të ZAZ nr. 26”. Procedura e shortit i është referuar nenit 14 të rregullores së KAS-it. Kemi përgatitur pesë shirita letre të bardhë, në njërin prej tyre është shënuar Kërkesa Ankimore nr. 7, të cilat palosen dhe dhe vendosen në pesë gogla me ngjyrë, formë dhe peshë të njëjtë, e më pas vendosen në një enë transparente. Pasi janë palosur të pesë shiritat e letrës, janë vendosur në goglat me peshë, ngjyrë dhe formë të njëjtë në enën transparente, anëtarët e KAS-it duke filluar nga rendi alfabetik rritës tërheqin goglat në enën transparente.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.6.03.2022*

Fillojmë me zotin Elvin Lako, i cili autorizon përfaqësuesen e KQZ të tërheqë gogllën - shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Vazhdojmë me zotin Elvis Çefa, i cili autorizon përfaqësuesen e KQZ të tërheqë gogllën - shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Vazhdojmë me zotin Ilirian Rusmali, i cili autorizon përfaqësuesen e KQZ të tërheqë gogllën - shiriti është i bardhë dhe pa shënime.


Vazhdojmë me zotin Koli Bele, i cili autorizon përfaqësuesen e KQZ të tërheqë gogllën - shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Vazhdojmë me zotin Ledio Braho, i cili autorizon përfaqësuesen e KQZ të tërheqë gogllën - Kërkesa Ankimore nr. 7.

Atëherë, në përfundim të procedurës së shortit, relator i Kërkesës Ankimore nr. 7, është zoti Ledio Braho, ju faleminderit!

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



RENDI I DITËS

Projektvendim "Për shqyrtimin paraprak të Kërkesës Ankimore nr. 7, ardhur në KQZ në datën 5.03.2022, subjekti ankues Partia Demokratike".

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Y. Merkaj, E. Mema.
- **Parti Politike:** PD (M. Logu)

Z. L. Braho: Hapim seancën paraprake për shqyrtimin e Kërkesës Ankimore nr. 7, datë 5 mars 2022, të depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në orën 23:20, nga subjekti zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë. Partia Demokratike e Shqipërisë ka ankimuar vendimin nr.171, datë 5.03.2022 të KZAZ-së nr. 26 që i përket Bashkisë Vorë. Zoti Sekretar i Përgjithshëm një relacion lidhur me këtë çështje.

Z. Y. Merkaj: KZAZ-ja nr. 26, Bashkia Vorë, në bazë të nenit 36 të Kodit Zgjedhor, ka kompetencë për të emëruar anëtarët e qendrave të votimit sipas propozimeve të partive politike. Duke qenë se lista e partisë politike për anëtarët e propozuar nga kjo parti është refuzuar nga KZAZ-ja nr. 26, pasi emrat e tyre nuk ishin banorë të zonës zgjedhore Bashkia Vorë, por ishin banorë jashtë kësaj zone zgjedhore u refuzuan. Ndërkohë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka hapur aplikimin për të emëruar kryesisht në vendet e mbetura vakante nga kjo situatë. Në faqen zyrtare të KQZ-së, aplikuan shumë persona të cilët janë emëruar kryesisht me vendimin nr. 130,

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt.06.03.2022

dt.5.03.2022 si anëtarë të KQV. Kjo listë e miratuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i ka shkuar KZAZ-së, e cila në bazë të nenit 36 ka kompetencën për të emëruar anëtarët e KQV-ve, të cilët me vendim nr. 171, datë 5.03.2022, kanë konstatuar se lista emërore e vendosur kryesisht sipas lidhjes nr. 1 të vendimit nr. 130 është po e njëjta listë emërore që KZAZ-ja ka kundërshtuar me vendimin e saj nr.170, si listë emërore që bie në kundërshtim me nenin 36, pika 5 të Kodit Zgjedhor. Kundër këtij vendimi, Partia Demokratike ka ushtruar ankim në KAS, pasi nuk është dakord dhe çështja është sjellë për shqyrtim pranë tavolinës tuaj, faleminderit!

Z. L. Braho: Faleminderit, zoti Sekretar i Përgjithshëm. Po përfaqësuesi i Partisë Demokratike. Prezent në seancë është zoti Marash Logu. Zoti Logu, në lidhje me elementët e formës dhe të përmbajtjes për këtë kërkesë ankimore.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Faleminderit zoti Braho. Besoj se kërkesa ankimore ju është vënë në dispozicion të gjithë anëtarëve të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve. Kërkesa ankimore respekton të gjithë elementët formalë dhe vlerësojmë që duhet të kalojë për shqyrtim në seancë publike, në mënyrë që ne të kemi mundësi të parashtrijmë të gjitha ato që përbëjnë argumentat tona dhe arësyen përse kemi vendosur që ta ankimojmë këtë vendim në KAS. Nga ana tjetër, në qoftë se më lejoni zoti Braho, shfrytëzoj rastin të kërkoj nga ana e administratës së KQZ-së se në fakt ka disa njoftime që vijnë nga ana e kësaj KZAZ-je për rrëmujë e të tjera, të merren të gjitha masat dhe të informohen që aktualisht është duke u zhvilluar një seancë në KAS për këtë çështje. Më pas besoj që dhe vendimmarrja e KAS-it do t'i sqarojë të gjitha palët në lidhje me veprimet që duhet të ndërmerren. Informoj KAS-in se sot përgjatë gjithë ditës ka pasur konflikte, tensione. Ka pasur një situatë shumë problematike për të cilën administrata mund ta konfirmojë në këtë

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.03.2022*

KZAZ për shkak të vendimmarrjeve të cilat në vlerësimin tonë bien katërcipërisht në kundërshtim me kërkesat e Kodit Zgjedhor dhe aktet nënligjore të nxjerra nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përkatësisht Udhëzimi nr. 2 i datës 5.12.2020. Këto janë, sigurisht elementë të themelit dhe nuk besoj se është ky momenti procedural për t'i parashtruar.

Z. L. Braho: Faleminderit zoti Logu! Ka ndonjë pyetje nga anëtarët e KAS-it në këtë seancë paraprake? Jo!

Atëherë, KAS-i pasi u këshillua në vend vendosi: kalimin për shqyrtim të Kërkesës Ankimore nr. 7, datë 5.03.2022 të subjektit zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë, kalimin e saj në seancë publike e cila do të zhvillohet menjëherë për shkak të emergjencës.

Vendimi nr. 13

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



RENDI I DITËS

Projektvendim "Për shqyrtimin e Kërkesës Ankimore nr. 7, ardhur në KQZ në datën 5.03.2022, subjekti ankues Partia Demokratike".

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Y. Merkaj, E. Mema, B. Kodra
- **Parti Politike:** PD (M. Logu)

Z. L. Braho: Çelimi seancën e hetimit administrativ të Kërkesës Ankimore nr. 7, datë 5 mars 2022, të subjektit zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë, me objekt "Kundërshtimin dhe shfuqizimin e vendimit nr.171, datë 5.03.2022 të KZAZ-së nr. 26 që i përket Bashkisë Vorë". Nga shorti i hedhur sot në KQZ, kjo kërkesë ankimore do të relatohet nga ana ime. Po ashtu gjatë seancës së hetimit paraprak, u vendos që të kalohet për shqyrtim administrativ. Tashmë çelimi seancën për të vijuar me pretendimet si fillim me... Kemi prezent përfaqësuesin e Partisë Demokratike që është dhe subjekti ankimues, zotin Marash Logu. Kemi prezent administratën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që përfaqësohet nga Sekretari i Përgjithshëm zoti Ylli Merkaj. Po ashtu janë të pranishëm dhe të gjithë anëtarët e KAS-it. Zoti Merkaj përmbledhtazi çfarë ka ndodhur në KZAZ-në nr. 26. Kemi një sërë vendimesh që na janë vënë në dispozicion. Na është vënë në dispozicion dhe një vendim i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Ju lutem një relacion të shkurtër!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.03.2022*

Z. Y. Merkaj: KZAZ-ja nr. 26, me vendim nr.170, datë 5.03.2022 ka vendosur të mos regjistrojë 104 kandidatë si kryetarë, sekretarë dhe anëtarë të KQV-ve. Ky mos regjistrim ka ardhur si rezultat pasi KZAZ-ja ka bërë verifikimin e kandidaturave të paraqitura nga Partia Demokratike ku 104 kandidatura nga lista e propozuar, rezultojnë se nuk janë banorë të zonës zgjedhore. Me arësytimin se këto propozime bien në kundërshtim me nenin 138, pika c të Kodit Zgjedhor, kanë vendosur të mos i regjistrojnë këta kandidatë. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka hapur aplikimin për të emëruar kryesisht personat për t'i emëruar anëtarë të KQV-ve. Thirrjes së KQZ-së, i janë përgjigjur 110 persona të cilët kanë aplikuar tek Faqja Zyrtare e KQZ-së. Janë emëruar kryesisht me vendimin nr. 130, dt.5.03.2022 si anëtarë të KQV nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Ky vendim i ka shkuar KZAZ-së, për të bërë emërimin sipas listës bashkëlidhur vendimit nr. 130. KZAZ-ja me vendimin nr. 171, datë 5.03.2022, ka konstatuar se lista emërore e vendosur kryesisht sipas lidhjes nr. 1 të vendimit nr. 130 është po e njëjta listë emërore që KZAZ-ja ka kundërshtuar me vendimin e saj nr.170, datë 5.03.2022. Kundër këtij vendimi, ka paraqitur ankim Partia Demokratike duke pretenduar se KZAZ-ja nr. 26, duhet të zbatonte vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve i cili ka emëruar kryesisht personat që do të shërbejnë si kryetarë, sekretarë dhe anëtarë të komisionit të qendrave të votimit të KZAZ-së nr. 26, faleminderit!

Z. L. Braho: Faleminderit, zoti Merkaj. Po, përfaqësuesi i Partisë Demokratike zoti Logu, fjala për ju! Shkurtimisht, ju lutem, pretendimet në lidhje me kërkesën ankimore.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Faleminderit zoti Braho. Mendoj se është e rëndësishme të bëjmë një histori të plotë të gjithë asaj që ka ndodhur sot në KZAZ-


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.03.2022*

në nr. 26 për të kuptuar paligjshmërinë e veprimeve që në fakt janë kryer nga një pjesë e anëtarëve të kësaj KZAZ-je, që përbëjnë dhe shumicën e saj. Konkretisht në orën 09:30, subjekti zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë, ka depozituar listën me 110 propozimet e saj për t'u emëruar si anëtarë, sekretarë dhe anëtarë të KQV-ve. Kjo kërkesë e cila është depozituar nga Partia Demokratike e Shqipërisë është shqyrtuar rreth orës 11:00 dhe në përfundim të saj, anëtarët e propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë dhe subjekti tjetër Lëvizja Socialiste për Integrim, pretendojnë se kanë konstatuar që këto persona të propozuar, nuk janë banorë të zonës Bashkia Vorë. Se si është kryer ky verifikim? Cili është mekanizmi, apo informacioni i marrë nga ora 9:30 deri në orën 11:00, nuk ka asnjë vendimmarrje, asnjë procesverbal të cilin e disponojmë me informacione të tjera. Nga ana tjetër, nga KZAZ-ja nr. 26, Bashkia Vorë i është dërguar një shkresë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, zotit Ilirjan Celibashi me nr. prot. 10, datë 5.03.2022, ku vihet në dijeni se kanë konstatuar se subjekti Partia Demokratike e Shqipërisë etj., etj., atë që relatoi dhe Sekretari i Përgjithshëm, i thuhet “mbetemi në pritje të veprimeve tuaja, në mënyrë që KZAZ-ja të procedojë për emërimin e anëtarëve të KQV-ve. Në fakt rezulton se ndaj kësaj shkrese Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me shkresën me numër protokolli 1586, datë 5.03.2022 i është përgjigjur se “ju sqarojmë se është në kompetencën tuaj për të vendosur emërimin e anëtarëve të KQV-së”. Për Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve ishte ana procedurale e paqartë, se çfarë kërkohet konkretisht nga ana e KZAZ-së nr. 26. I është kërkuar dhe e citoj “në çdo rast veprimtaria juaj duhet të shoqërohet me vendimmarrje”. Pra, duhet që KZAZ-ja nr. 26 ndaj kërkesës së Partisë Demokratike të kishte proceduar me një vendimmarrje. Me një vendim që ka numër “x”, datë “y” dhe u njoftohet subjekteve zgjedhore dhe palëve të interesuara. Në këtë kohë, duke qenë se, Komisioneri Shtetëror ka konstatuar krijimin e vakancës në plotësimin e

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.03.2022*

anëtarëve të qendrave të votimit, me vendimin nr. 130, datë 5.03.2022, ka vënë në dispozicion KZAZ-së nr. 26 një listë të shtetasve të cilët ishin të interesuar për t'u emëruar kryesisht si anëtarë, sekretarë, apo kryetarë të KQV-ve. Po ashtu, duke pasur parasysh që ishin shumë pak orë përpara fillimit zyrtarisht të çeljes së votimeve, nuk ishte bërë e mundur shpërndarja e materialeve zgjedhore, siç e keni dhe pjesë të provave që ne kemi vënë në dispozicion të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve. Nga ana e Partisë Demokratike, Dega Vorë, ju është drejtuar dhe një shkresë zyrtarisht me nr. prot. 106, datë 5.03.2022 KZAZ-së nr. 26, ku i kërkohet zbatimi i menjëhershëm i vendimit nr. 130, datë 5.03.2022 i KSHZ. Sigurisht, edhe pse ne besonim që ishim cënuar me një vendimmarrje që nuk po bëhej publike, informoj KAS-in që ne, deri në orën 20:30 nuk kemi pas asnjë vendim lidhur me kërkesën që ishte depozituar në orën 9:30 nga ana e subjektit zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë. Në vlerësimin tonë, ky është dhe shkak i këtij ankimi, KZAZ-ja ka vepruar në kundërshtim me ligjin dhe udhëzimin nr. 2, datë 5.12.2020 të Komisionit Rregullator, në momentin që KZAZ-ja, e paprecedentë ndonjëherë, vendos ajo vetë "a do të zbatohet, apo jo një vendim të KSHZ". Jo vetëm vendos, por hyn edhe meritave të vendimit. Neni 11 i udhëzimit nr. 2, datë 5.12.2020 ka qenë shumë i qartë se kujt i takon kompetenca për të verifikuar, në qoftë se shtetasit që kanë shfaqur interesin për t'u emëruar si anëtarë të KQV-ve, përmbushin apo jo kriteret ligjore. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi ka marrë aplikimet, ka kryer verifikimet përkatëse siç ja imponon neni 11 i udhëzimit nr. 2, datë 5.12.2020 dhe i ka përcjellë listën KZAZ-së nr. 26. Në momentin që KZAZ-ja ka pasur në dispozicion këtë listë, nuk ka asnjë lloj kompetence, asnjë lloj të drejte që t'i hyjë verifikimit të listës që i vihet në dispozicion nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Sipas nenit 12 të udhëzimit nr. 12/2020, KZAZ-ja ka detyrën që nga kjo listë të emërojë kryetarët, sekretarët dhe anëtarët e KQV-ve. Edhe në këtë rast, pavarësisht

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.03.2022*


se shkresa e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, edhe vendimmarrja e KSHZ, i është vënë në dispozicion KZAZ-së brenda orarit zyrtar të punës, ne kemi marrë vendimin nr. 171 dhe është arësyeja pse po zhvillohet kjo seancë në këtë orë në fakt, vetëm rreth orës 20:00 pra, në zvarritje të vendimmarrjes dhe vënies në dispozicion. Mendoj se dhe kjo do të jetë objekt shqyrtimi administrativ të Komisionerit Shtetëror, përse i përket sjelljes së disa anëtarëve të KZAZ-së, ndoshta dhe të përgjegjësive penale që ata kanë për disa shkelje që kanë kryer në ligjet. Por ajo që ka rëndësi është fakti që vendimi nr. 171, datë 5.03.2022 i KZAZ-së nr. 26, vjen haptazi, në mënyrë flagrante, në kundërshtim me nenet 11 dhe 12 të udhëzimit nr. 2, datë 5.12.2020 që rregullojnë në mënyrë të detajuar se si bëhet emërimi i anëtarëve kryesisht të KQV-ve. Kjo është arësyeja, të nderuar anëtarë të KAS-it, pse ne kemi kërkuar shfuqizimin e këtij vendimi dhe urdhërimin e KZAZ-së që të procedojë me zbatimin e vendimit të KSHZ nr. 130, datë 5.03.2022.

Z. L. Braho: Faleminderit zoti Logu! Pra, me sa kuptova unë, ajo që kërkonte ju është që të zbatohet nga KZAZ-ja nr. 26, vendimi nr. 130, datë 5.03.2022 i KSHZ?

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Po zoti Braho, sepse çdo vendimmarrje tjetër e KZAZ-së vjen në kundërshtim me nenet 11 dhe 12 të udhëzimit nr. 2 datë 5.12.2020 të Komisionit Rregullator.

Z. L. Braho: Dakord! Faleminderit! Zoti Merkaj një pyetje se u konstatua dhe nga një anëtar i KAS-it që ky vendimi nr. 171 në fakt është vendim konstatimi i KZAZ-së. Pra, s'ka as refuzim, as... pra, ata janë në kushtet e mosveprimit? Nuk duan të zbatojnë një vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve? Duam të jemi të qartë!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sankcioneve
Dt.06.03.2022*

Z. Y. Merkaj: Ata kanë marrë një vendim të mëparshëm dhe kanë refuzuar një listë. E njejta listë i ka ardhur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Ata kanë marrë vendim duke thënë që kjo listë është e njejta që ne kemi refuzuar njëherë, sepse nuk janë banorë të zonës dhe është në kundërshtim me nenin 38, pika “c” të Kodit Zgjedhor.


Z. K. Bele: Në fakt ata nuk kanë marrë vendim, thjesht kanë bërë një konstatim dhe thonë është e njejta. Pastaj nuk thonë se çfarë do të bëjnë me këtë konstatim. Kjo në kuptueshmërinë time, ose tonën është kuptuar si refuzim. Shoh dhe mendimin e pakicës që thotë “ne jemi kundër”, pra kuptohet shumica nga ajo që ka thënë pakica. Ndoshta dhe koha e shpejtë, nxitimi për zbardhjen.

Z. L. Braho: Ka ndonjë pyetje nga anëtarët?

Z. I. Rusmali: A ka informacion përfaqësuesi i subjektit? Në këtë konstatim, ata shtojnë një gjysëm fjalië ku thonë “nuk jemi në kushtet e mungesës së kuorumit për KQV-të” dhe nuk kemi nevojë ta vemë në përdorim listën, në qoftë se e interpretojmë saktë këtë që kanë shkruar. Si është situata atje, cila është dijenia juaj?

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Faleminderit zoti Rusmali për pyetjen. Në dijeninë tonë, mosemërimi i kryetarëve dhe sekretarëve të KQV-ve, ka pamundësuar shpërndarjen e materialeve zgjedhore që është premisë për të garantuar ditën e nesërme mbarëvajtjen e procesit zgjedhor. Pra, qartazi vakancat e krijuara kanë impakt të drejtë për drejtë në mbarëvajtjen e procesit zgjedhor. Aktualisht këtë mund ta konfirmojë dhe administrata në qoftë se bën një komunikim me kryetarin, sekretarin e KZAZ-së. Ka një tensionim shumë të madh në KZAZ lidhur me

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.03.2022*

shpërndarjen e materialeve zgjedhore. Këtu kam parasysh jo vetëm paisjet, sepse në disa zona është bërë e mundur shpërndarja e paisjeve, duke qenë se votimi do të kryhet në formë elektronike, por gjithë materiali tjetër që garanton procesin zgjedhor. Ky është informacioni që ne kemi.

Z. I. Rusmali: Ju flisni për kryetarin dhe sekretarin. Sekretarin unë mund ta kuptoj, por kryetari është pjesë e kuorumit. Pse duhet emëruar kryetari në rastet kur kuorumi ekziston?

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Zoti Rusmali, ky është informacion që unë e disponoj. Në qoftë se janë anëtarët e mjaftueshëm për të krijuar kuorumin etj., etj., ajo që di tu them është se ju e dini që sipas Kodit Zgjedhor dhe akteve nënligjore, sekretari dhe kryetari i KQV-ve ka disa detyra shumë specifike, që garantojnë mbarëvajtjen e procesit zgjedhor në qendrat e votimit. Duke filluar nga marrja në dorëzim e materialit zgjedhor dhe më pas ndjekja hap pas hapi e të gjitha procedurave. Kjo është arsyeja dhe fakt pse detyrimisht duhet që KZAZ-të duhet të procedojnë me emërimin e kryetarëve dhe sekretarëve të qendrave të votimit, të cilët sipas shortit të hedhur ashtu siç e parashikon ligji në gjysmat e qendrave të votimit kryetari i takon partisë së dytë parlamentare që përkon me Partinë Demokratike të Shqipërisë dhe gjysma tjetër sekretari i takon partisë së dytë parlamentare që po ashtu përkon me Partinë Demokratike të Shqipërisë. Megjithatë, po them që të gjitha ato që kanë ndodhur sot patëm mundësinë t'i relatojmë. Për ne është tërësisht e pakuptueshme dhe jo vetëm, por dhe jo ligjore, se si e gjen dhe ku e gjen aftësinë, kompetencën, apo të drejtën kjo KZAZ...

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.03.2022*

Z. I. Rusmali: Kjo është temë tjetër, këtë e kemi të qartë, ju e shtjelluat deri në fund. Mos të dalim nga pyetja.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Ky është informacioni që ne disponojmë.

Z. E. Çefa: Zoti Logu, po i kthehem dhe njëherë fillimit të ligjëratës tuaj. Ju cituat që “KZAZ-ja rreth orës 11 ka refuzuar me vendim listën e dërguar rreth orës 9:00 nga Partia Demokratike. Pyetja ime është: ju me termin “ka refuzuar”, i referoheni dispozitivit të vendimit nr. 170, apo ka ndonjë akt tjetër refuzimi përpara atij në vendim?

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Faleminderit për pyetjen zoti Çefa, në fakt ka pasur një mbledhje. Ju e dini që partitë kanë të drejtën të propozojnë dhe kanë kontaktet e tyre pranë KZAZ-ve. Jemi informuar për këtë mbledhje. Jemi informuar që ka pasur një diskutim dhe një votim “pro” dhe “kundër” lidhur me miratimin e kësaj liste. Kemi pritur siç është praktika normale që të na vihej në dispozicion një vendim. Vendim nuk kemi pasur në kuptimin formal që të kemi një vendim me numër, me datë, me përmbajtje. Nuk ka pasur deri në orën 20:30 dhe këtë gjë mund ta konfirmojë dhe komunikimi që kanë pasur strukturat tona me KZAZ-në përkatëse. Kjo është ajo që ne... ndërkohë që përpara këtij orari, kishte pasur një komunikim që unë ju’a citova nëpërmjet Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Kishte pas madje dhe një kërkesë nga ana e Partisë Demokratike, strukturat tona në Vorë që të zbatohet vendimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, sepse ishim vonë. Në kushtet kur shumica në KZAZ dëshironte që të fillonte shpërndarjen e materialeve zgjedhore, para se të zgjidhej çështja e emërimit të sekretarëve dhe të kryetarëve në gjysmat për kryetarë dhe gjysmën tjetër për sekretarët. Pra, ne ishim në kushtet kur procesi po

Zbardhi materialin audio

Meriça DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.03.2022*

fillonte të administrohej në mënyrë krejtësisht të njëanshme, pasi jo vetëm Partia Demokratike e Shqipërisë nuk kishte anëtarët e saj në komisione, por nuk kishte dhe anëtarët e tjerë që mund të ofronin minimumin e garancisë që nuk do të kryeheshin shkelje që çënojnë procesin zgjedhor.

Z. E. Çefa: Pra, me gjasë po flasim për vendimin nr. 170, i cili ju është vënë në dispozicion me shumë vonesë?

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Po!

Z. E. Çefa: Dhe nuk e keni objekt ankimi në fakt! Edhe me kolegët vumë re që ky vendim është thelbi i fillimit të mosmarrëveshjes dhe më pas ka ardhur vendimi nr. 171 të cilin ju e keni ankimuar. Ndoshta për procedurë, ju mbase do të duhet të kërkonit shtimit të objektit të ankimit dhe përfshirjen e vendimit nr. 170 në ankim, në mënyrë që ne të kemi një panoramë tërësore të situatës pastaj.

Z. I. Rusmali: Jo domosdoshmërisht, në vullnetin e tij, po të dojë ta shtojë...

Z. E. Çefa: Sigurisht kjo është një pyetje në formë sugjerimi, megjithatë për ...

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Faleminderit zoti Çefa, dëshiroj të bëj një sqarim që është i rëndësishëm edhe për... pavarësisht se jemi në një orar që nuk e di sa do të jetë...

Z. L. Braho: Zoti Logu! Përpara se të bëni sqarimin kam unë një pyetje për administratën që besoj se lidhet dhe më këtë çfarë thanë dhe anëtarët e tjerë të KAS-

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.03.2022*

it. Zoti Merkaj, për këta anëtarët e KQV-ve që janë pjesë e zgjedhjeve me votim elektronik, ka ndonjë trajnim specifik nga KQZ-ja? Anëtarët, sekretarët...

Z. Y. Merkaj: Janë trajnuar por është operatori që merret me paisjen PEVN, nuk janë të trajnuar anëtarët e KQV. Ata kryejnë detyrat si në çdo rast. Operatori ka detyra më specifike dhe është trajnuar për ato detyra.

Z. L. Braho: Dakord, faleminderit! Po zoti Logu, vazhdoni!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Faleminderit zoti Braho! Dëshiroj në fakt edhe për anëtarët e KAS-it, por ndoshta dhe më gjerë, megjithëse jemi në një orar që dyshoj se këtë seancë e ndjekin dhe palë të tjera. Informoj se ka një praktikë të partive politike që anëtarët e KQV-ve, përgjithësisht emërohen të njëjtët që kanë qenë dhe në zgjedhjet e mëparshme. Siç e dini, ne vetëm pak kohë më parë kemi kaluar procesin zgjedhor të 25 prillit, në të cilin koncepti i zonës zgjedhore.., sigurisht që ndoshta këtu strukturat përkatëse të subjektit që unë përfaqësoj.., në zgjedhjet parlamentare zonë zgjedhore konsideronin qarkun. Në zgjedhjet vendore zonë zgjedhore konsiderohet bashkia. Kjo ka qenë arsyeja që në disa raste propozimet që kanë ardhur nga subjekti zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë, kanë qenë qytetarë të cilët e kanë vendbanimin e tyre brenda Qarkut të Tiranës, por jo domosdoshmërisht brenda zonës zgjedhore Bashkia Vorë. Nga ana tjetër zoti Braho dhe të nderuar anëtarë të komisionit fakti që po zhvillohej në Bashkinë Vorë për herë të parë procesi i votimit dhe numërimit elektronik ka qenë qasja e subjektit tonë zgjedhor që në atë proces, të paktën në disa qendra që ne i kemi vlerësuar të rëndësishëm, të angazhonim disa komisionerë që kishin qenë të angazhuar dhe në Njësinë Administrative nr. 10 në Tiranë. Këta para një viti kanë qenë në një proces

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.03.2022*

të ngjashëm. Pra, ne i kemi kushtuar më shumë vëmendje faktit që është dhe një nga kriteret ligjore që “personat që caktohen si komisionerë të kenë eksperiencë të ngjashme në procese zgjedhore të mëparëshme”. Sigurisht që kjo ka sjellë atë vendimmarrje që tashmë dihet të KZAZ-së. Vendimmarrje me të cilën ne jemi njohur shumë vonë. Vendimmarrje të cilën kemi menduar se fakti që gjendemi vetëm pak orë para fillimit të procesit të votimit dhe KZAZ-ja kishte tashmë një listë nga KQZ-ja, duhej të procedohej me këtë listë. Kjo, në mënyrë që gjithësesi subjektit zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë, megjithëse refuzimit për të qenë pjesë e KQV, t’i garantohej, të kishte një minimum garancie se në KQV-të nuk do të kishte anëtarë vetëm të një pale, ashtu siç rezulton nga të gjitha votimet që janë kryer në KZAZ. Po do të kishte dhe një palë tjetër për të kryer sadopak një lloj balance, qoftë në vendimmarrje, qoftë në monitorimin e gjithë procesit. Kjo ndoshta i jep disi përgjigje edhe sugjerimit që me të drejtë parashtroi zoti Çefa. Ndërkohë që për ne është e qartë tashmë se ka një vendim nr. 171, datë 5.03.2022, që vjen në kundërshtim të qartë me dispozitat ligjore, përkatësisht në udhëzimin e nxjerrë nga Komisioni Rregullator. Do të kërkoja dhe do t’u ftoja që ta fokusojmë gjithë vëmendjen tek ato çfarë parashikojnë nenet 10, 11 dhe 12 të këtij udhëzimi që e rregullojnë se si bëhet emërimi i anëtarëve kryesisht në KQV, sepse janë shumë të qarta, shumë eksplicite, nuk është thjesht dhe vetëm një udhëzim, është aq i detajuar, gati sa një rregullore. E ka përcaktuar në nënyrë shumë të qartë dhe detajuar se si do të bëheshin këto emërimet në rastet e përballjes me një situatë të tillë, siç parashikohet dhe nga neni 36, pika 5 e Kodit Zgjedhor.

Z. L. Braho: Zoti Logu, dakord me të gjitha, por për të sqaruar një gjë. Ju i qëndroni vetëm listës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, me vendimin nr.130, apo si

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.03.2022*

kërkim alternativ keni dhe listat që ka depozituar Partia Demokratike dhe që janë refuzuar me vendimin nr. 170 të KZAZ-së?

Z. K. Bele: Më fal, para se të përgjigjet zoti Logu, për të kuptuar. Në qoftë se unë e kuptova drejt zoti Logu, ajo që ju parashtruat është që vendimi nr. 171..., ose ankimi juaj ndaj vendimit nr. 171 riparon situatën në tërësi, pa u dashur që të shkohet tek vendimi i mëparshëm. Ju kuptova drejt? Nisur dhe nga emergjenca kohore që kemi!


Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Absolutisht po!

Z. K. Bele: Dakord!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Tani që ne po flasim jemi në më pak se gjashtë orë nga çelja zyrtare e procesit të votimit. Në qoftë se do t'i ktheheshim mbrapsh historisë që të fillonte që subjektet zgjedhore të gjenin komisionerë etj., etj., mendoj që do ta vinim seriozisht në dyshim, apo në rrezik procesin zgjedhor që zhvillohet ditën e sotme në fakt në Bashkinë Vorë. E bëra shpjegimin zoti Bele dhe të falenderoj për pyetjen, vetëm e vetëm për të sqaruar një lloj amullie që është krijuar në fakt dhe e sponsorizuar në opinionin publik gjatë gjithë ditës lidhur me propozimet tona për komisionerë në Bashkinë Vorë. Megjithëse, edhe administrata mund ta konfirmojë që ka pasur praktika të tilla të ngjashme edhe në procese zgjedhore të mëparëshme dhe ka pas një lloj tolerance më të madhe nga ana e administratës zgjedhore. Ndoshta dhe për rrethanat specifike kur këto zgjedhje po ndodhin imponojnë disa lloj vendimmarrje të caktuara.

Z. L. Braho: Faleminderit zoti Logu! Po zoti Çefa!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sankstoneve
Dt.06.03.2022*

Z. E. Çefa: Pyetja e fundit. Përfundimisht, emrat e propozuar në të dy rastet që qenkan të njetit siç po rezulton, a e plotësojnë, apo jo kriterin e pikës 1/c të nenit 38 të Kodit Zgjedhor? Dmth, personat e propozuar, a janë me vendbanim në zonën zgjedhore përkatëse, apo jo?

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Faleminderit zoti Çefa! Unë do t'u ftoja të më lejoni të fokusohemi tek neni 11, pika 2 e vendimit të Komisionit Rregullator, që shpreh qartësisht se "është objekt i verifikimit nga administrata e KQZ-së përmbushja e kushteve për emërimin si anëtarë të KQV-ve". Për sa kohë që është kryer ky verifikim, nuk kemi arsye të vemë në dyshim punën e administratës së KQZ-së. Ka pasur një vendimmarrje të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, që ka konfirmuar verifikimet e kryera nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Ndaj këtij vendimi nuk ka asnjë ankim, pra nuk ka një ankim as KZAZ-ja, as ndonjë subjekt tjetër nuk e ka vënë në dyshim këtë. Subjektet, dikush që mund të kishte interes, sepse dhe anëtarët e KZAZ-së përfaqësojnë interesa të caktuara, apo subjekte të caktuara. Pra, nuk ka një ankim të paraqitur për këtë çështje. Vendimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve është në fuqi. Unë nuk di, këtë duhet ta marrim me rezervë janë të njejtët, apo s'janë të njejtët. As unë, por as ju nuk jemi ulur të shohim emra, gjeneralitete, të bëjmë krahasime etj., etj.. Për sa kohë kemi një vendimmarrje të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nuk ka asnjë arsye që ne të vemë në dyshim përmbushjen e kriterëve dhe kushteve që parashikon ligji lidhur me këta shtetas që janë propozuar për t'u emëruar kryesisht në KQV-të. Ashtu si në fakt nuk është e drejtë, as detyrë, as kompetencë e KZAZ-së që ta kryejë këtë verifikim.

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.03.2022*

Z. E. Çefa: Arësyeja pse e bëra pyetjen ishte në fakt pretendimi juaj që KZAZ-ja nuk ka kryer asnjë lloj verifikimi. Vendimi për mospranimin për këtë arësye është abuziv. Mendova që për sa kohë ju konkludoni se vendimi i tyre është abuziv, keni dokumente mjaftueshëm që këtë të na e vërtetoni edhe ne. Megjithatë të njejtën pyetje ia drejtoj administratës.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Zoti Çefa, me konkluzionin tuaj nuk jam shumë i qartë!

Z. E. Çefa: Atëherë, ju thatë që “veprimi i kryer nga KZAZ-ja në refuzimin e listës, me argumentin që e kanë verifikuar vendbanimin dhe nuk rezulton asnjë person në listë banor i zonës zgjedhore është abuziv”, thatë ju. Tani që të na e vërtetoni ju këtë, duhet të na provoni që e kundërta është e vërtetë. Pra, që këta janë banorë të zonës zgjedhore, prandaj dhe unë të bëra këtë pyetje.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Zoti Çefa, të mos ngatërrojmë dy vendimmarrjet! Për sa i përket vendimmarrjes së parë, pra vendimit që kishte të bënte me vendimin nr. 170 ishte ajo që ju sapo cituat. Ne objekt të ankimit nuk kemi vendimin nr. 170. Për sa kohë që nuk e kemi sjellë si objekt ankimi nuk kemi detyrimin që të provojmë... të themi nuk jemi këtu për të provuar diçka tjetër. Nga ana tjetër, për sa i përket vendimit nr. 171, për ne kjo vendimmarrje është e paligjshme, sepse KZAZ-ja nuk ka të drejtë që t’i hyjë një verifikimi që në fakt është detyrë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Z. E. Çefa: Po e qartë, të kuptova! Zoti Sekretar i Përgjithshëm, nuk e di nëse keni mjaftueshëm informacion për t’iu përgjigjur pyetjes!

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.03.2022*

Z. Y. Merkaç: Aplikimi në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është hapur në orën 13:00 dhe në orën 16:00, pas tre orësh kemi pasur 110 -120 persona, madje tani vazhdojnë akoma, janë dhe 40 persona të tjerë që kanë bërë aplikimin. Në orën 16:00, Komisioneri ka miratuar këtë listë. Ne nuk është se kemi bërë verifikim të thelluar, por kemi marrë vetëdeklarimin që kanë bërë aplikuesit. Ata kanë deklaruar emër mbiemër, datëlindjen dhe vendbanimin që janë banorë të zonës zgjedhore Bashkia Vorë. Duke u bazuar në këtë vetëdeklarim, kemi bërë dhe miratimin e listës emërore.

Z. E. Çefa: Dakord, dakord! Faleminderit, nuk kam pyetje!

Z. I. Rusmali: Të bëj një pyetje?

Z. L. Braho: Po zoti Rusmali!

Z. I. Rusmali: Është një gjë që më bën përshtypje te kjo tema e vetingut të këtyre personave. KZAZ-ja thotë dhe e shkruan këtë gjë që “ne kemi bërë verifikimin e vendbanimit të këtyre personave nëpërmjet sistemit e-Albania”. Adresa është e dhënë personale e individit e-Albania e mundëson për këdo verifikimin e adresës së banimit për këdo person tjetër?

Z. B. Kodra: Edhe ne u munduam ta verifikonim me e-Albania, por në formular mungonte atësia e këtyre personave dhe ishte e pamundur. Tentuam dhe me listën e zgjedhësve që të gjenim vendndodhjen e tyre, por nga këto burime nuk e gjenim dot.

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.03.2022*

Z. I. Rusmali: Si merren këto? Lista e zgjedhësve është një histori tjetër!

Z. B. Kodra: Ne u munduam të verifikonim vetëm vendbanimin e tyre. Ata e kanë deklaruar vetë që janë në Vorë, në Bërxull në njësinë administrative. Për sa u munduam të kërkonim ne, nuk mundëm të gjenim dot një burim se ku do t'i verifikonim, pasi u mungonte atësia këtyre personave.

Z. I. Rusmali: Qartë!


Z. B. Kodra: Kështu që morëm të mirëqenë faktin që ata vetë kanë deklaruar duke pas parasysh që në formular është dhe shprehja “deklaroj në përgjegjësinë time që këto të dhëna janë të sakta”. Ne pasqyruam në atë listë vetëm ata persona që kanë kërkuar në bazë të formularit që ne kemi shkarkuar në faqe.

Z. L. Braho: Pyetje tjetër ka? Dakord! Përfundimisht zoti Logu, çfarë kërkonte nga KAS-i?

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Përfundimisht kërkojmë, shfuqizimin e vendimit nr. 171, datë 5.03.2022 të KZAZ-së nr. 26, Bashkia Vorë për shkak se vjen në kundërshtim flagrant me nenet 11 dhe 12 të udhëzimit nr. 2, datë 5.12.2020 të Komisionit Rregullator.

Z. L. Braho: Faleminderit! Atëherë KAS-i do të tërhiqet për vendim, besoj për 15 minuta do të shpallim vendimin.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.03.2022*

Rifillon seanca

Ora 01:52

Z. L. Braho: Atëherë, KAS-i pasi u tërhoq për vendim, në zbatim të nenit 143, pika 1, shkronja “c” të Kodit Zgjedhor, vendosi:

Pranimin e ankimit të subjektit zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë dhe shfuqizimin e vendimin nr. 171, datë 5.03.2022 të KZAZ-nr. 26.

Detyrimin e KZAZ-së nr. 26 për të bërë emërimin e sekretarëve dhe anëtarëve të KQV-ve, në ato raste ku kuorumi nuk plotësohet, sipas listës bashkëlidhur vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 130, datë 5.03.2022.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë!

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda pesë ditëve në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Administrativ në Tiranë.

Shkurtimisht, ose më saktë argumenti që KAS-i pranoi ankimin e Partisë Demokratike ka të bëjë me faktin që vendimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve është një vendim i padiskutueshëm për KZAZ-të dhe për këtë arsye nuk mund të diskutohet, apo të bëhen konstatime në lidhje me këto vendimmarrje nga KZAZ-të.

Deklarojmë mbledhjen të mbyllur, faleminderit!

Vendimi nr. 14

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU

